



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.04.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Enggroup” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projektit për ndertim të lartë”, me Nr. të Prok: 632-21-645-2-2-1, nxjerr:

### V E N D I M

- I. Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik “Enggroup” SH.P.K e dt.16.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Hartimi i projektit për ndertim të lartë**, me Nr. të Prok: 632-21-645-2-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-006-221, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 12.04.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES e publikuar me datë: 12.04.2021;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit të ktheje ne Rivlersim .**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

### A r s y e t i m

Meqë Operatori Ekonomik “Enggroup” SH.P.K, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **Hartimi i projektit për ndertim të lartë**, me Nr. të Prok: 632-21-645-2-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-006-221,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 19.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**1.Për pretendimin tuaj se:**

*"Pasi morem te gjithë dokumentacionin e kompanise fituese pame qe AK nuk ka kerkuar nga OE shpjegime per cmim jo normalisht te ulet edhe pse OE ka permbushur te gjitha kushtet e tenderit me cmim jo normalisht te ulet:*

*i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;*

*ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;*

*iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë."*

**Pas rishikimit te dokumenteve Autoriteti kontraktues sqaron se:** Pretendimi juaj se Operatori Ekonomik i përzgjedhur nga Autoriteti Kontraktues ka çmim jo-normalisht të ulët, është i bazuar dhe aktivitetin e prokurimit do ta ktheje ne Rivlersim;

**2.Pretendimi juaj se:**

"Gjithashtu ne mendojme qe AK ka bere shkelje te Udhezimit Administrativ UA 16/2016 te aprovuar nga Ministria e Arsimit mbi parimet dhe procedurat e njohjes se diplomave, gradave dhe kualifikimeve te shkollave te larta profesionale dhe Universitare te fituara jashte Republikes se Kosoves. Ne kete UA shkruan qe te gjitha diplomat e shkollave te larta profesionale dhe universitare te fituara jashte vendit me qellim punesimi apo interesit juridik ne RK, do te duhet te ju nenshtrohen procedurave te njohjes/barasvleres ne MASHT-kompetence kjo qe i takon Qendres NARIC ne MASHT- gje qe AK nuk e ka kerkuar per inxhinjeret e kompanise te shpallur fituese, kompani e cila ka prezentuar gati se te gjithë inxhinjeret te diplomuar jashte shtetit tonegje qe do te duhej te ju nenshtroheshin procedurave te nostrifikimit."

**Autoriteti kontraktues sqaron se:** ky pretendim i juaj është i pa bazuar sepse një gjë e tillë nuk është kërkuar në dosje të tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b> <b>Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses referenca të cilat dëshmojnë se ka kryer shërbime në projektim të ndërtimit të lartë në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>  <b>Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha shërbimet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar shërbimet e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të shërbimeve – (së paku një referencë ose raport të</b>
---	-----------	--	--

	<p>publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 180.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme</p>	<p>pranimi të shërbimeve e cila përputhet me listen e dorëzuar), në rast kur OE prezenton kontrata-referenca me OE privatë atëherë OE duhet te prezentohen situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontrate-referencë.</p>
	<p>Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit. a.)Një projekt menaxher ( inxhinier i Diplomuar ose master te Ndërtimit dhe Arkitekturës(të emërohet me vendim nga OE) me përvojë pune në menaxhimin e projekteve (të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune pas diplomimit b.) Dy Ixhinier të diplomuar ose master ndërtimtarisë dhe arkitekturës drejtimi arkitekturë me 3 vjetë provoj pune pas diplomimit në projektim të ndërtimit të lartë. C.) Dy Ixhinier të diplomuar ose master ndërtimtarisë dhe arkitekturës drejtimi konstruktivë me 3 vjetë provoj pune pas diplomimit në projektim të ndërtimit të lartë. d.)Një Ixhinier të diplomuar ose master ndërtimtarisë dhe arkitekturës drejtimi hidroteknikë me 3 vjetë provoj pune pas diplomimit në projektim të ndërtimit të lartë. e.)Një Ixhinier të diplomuar ose master elektroteknikës drejtimi energjikë me 3 vjetë provoj</p>	<p>Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontrat, përvoja e punës të dëshmohet me CV dhe referenca).për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshminë dhe vendimi për projekt menaxherin.</p>

	<p>pune pas diplomimit f.) Një Ixhinier të diplomuar ose master të inxhinierisë mekanike drejtimi termoenergjetik me 3 vjetë provoj pune pas diplomimit g.) Një Ixhinier të diplomuar ose master të inxhinierisë ndëtimimit dhe arkitekturës drejtimi gjedozi me 3 vjetë provoj pune pas diplomimit</p> <p>Për pikat me sipër Autoriteti Kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike e profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.</p>	
--	---	--

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara  
Arkivit të Komunës

z. Faton Gutaj

---

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

